



Superintendent

20 Prill, 2020

Të Nderuar Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Sot filluam mësimin dixhital zyrtar për studentët të drejtuar nga mësuesit. Këtu keni disa informacione të rëndësishme për ju ndërsa ne punojmë së bashku për të ndihmuar çdo student të mësojë dhe të fitojë aftësi të reja për pjesën e mbetur të vitit shkollor.

E Martë, 28 Prill do të jetë një ditë shkollore, shkollat do të mbyllen në 2 Qershor

Në kalendarin aktual shkollor, Dita e Zgjedhjeve ishte caktuar për të Martën, 28 Prill dhe shkollat ishin planifikuar të mbyllen. Për shkak të shqetësimeve të COVID-19, shteti e ka zhvendosur Ditën e Zgjedhjeve në 2 Qershor 2020. Prandaj, studentët do të marrin pjesë në mësimin dixhital më 28 Prill si një ditë shkollore. Shkollat tani do të mbyllen të martën, 2 Qershor për të siguruar që ne të nderojmë Ditën e Zgjedhjeve të Shtetit në kalendarin tonë si gjithmonë.

Keni nevojë për ndihmë me Chromebook tuaj të lëshuar nga Drejtoria apo nuk e keni kini marrë akoma?

Nëse kompjuteri juaj i dhënë nga Drejtoria ka nevojë për riparim ose shërbim, mund ta sillni atë në një nga këto dy Qendra të Teknologjisë së Prindërve dhe Familjeve të listuara më poshtë. Mund të merrni gjithashtu hua një kompjuter në këto qendra nëse nuk e keni marrë atë akoma në shkollën e fëmijës suaj. Prindërve, kujdestarëve ose ndonjë i rritur i shënuar si një kontakt urgjent për një student, u kërkohet të sjellin një ID (dokument identifikimi me fotografi) për të marrë hua një kompjuter. Studentët e shkollave të mesme duhet të sjellin ID e tyre të shkollës. Të dy qendrat do të jenë hapur nga dita e Hënë deri të Premten nga 9:00 e mëngjesit - 4 pasdite, përjashtuar ditët e festave.

Education Center(Qendra e Edukimit)

440 N. Broad Street, Holli i Katit të 1-rë, Filadelfia, PA 19130

Fitzpatrick Annex Building (pjesa e pasme e shkollës fillore Fitzpatrick)

4101 Chalfont Drive, Philadelphia PA 19154

Ne gjithashtu tani kemi një linjë telefonike të përkushtuar për ndihmë (215-400-4444) dhe email (FamilyTechSupport@philasd.org) posaçërisht për prindërit dhe studentët për t'ju ndihmuar që pajisja juaj e dhënë nga Drejtoria të funksionojë. Këto ju ndihmojnë dhe për çështje teknike me kompjuter të prishur ose kur ai nuk punon mirë. Informacioni në lidhje me aksesin pa kosto ose kosto të ulët në internet është në dispozicion [këtu](#).

Keni nevojë për më shumë ndihmë të mësoni se si të përdorni kompjuterin e dhënë nga Drejtoria?

Ne kemi fazat(Steppers) të disponueshëm për familjet në Resource Center for Remote Learning (mesi i faqes) këtu: www.philasd.org/chromebooks.

Plani dhe burimet dixhitale të të mësuarit

Një mjet i ri për familjet PreK dhe materialet mësimore për të gjitha lëndët dhe nivelet e klasave për familjet K-12 tani janë të disponueshme në faqen tonë të internetit të Digital Learning Activities në www.philasd.org/digitalllearning. Materialet e reja K-12 do të shtohen çdo javë, në mënyrë që të shihni se çfarë do të mësojë fëmija juaj për javën e ardhshme.

Kontakti me mësuesit, këshilltarët e shkollës dhe infermierët


Orët e punës për mësuesit, këshilltarët e shkollës dhe infermierin e shkollës postohen në faqen e internetit të secilës shkollë për të mbështetur më tej mësimin e fëmijës tuaj në shtëpi. Orët zyrtare për mësuesit janë posaçërisht për mesimdhënie dhe angazhim me studentët. Prindërit inkurajohen të lidhen me mësuesit të cilët përdorin Google Classroom.

Të gjithë ne jemi të entuziazmuar që bashkëpunojmë me ju në këtë fazë të re të mësimin dixhital për studentët, e cila do të zgjasë deri në fund të vitit shkollor në 12 Qershor.

Ne vazhdojmë të punojmë përmes shumë aspekteve të operacioneve tona shkollore të pa parashikuara në këtë kohë dhe do t'ju mbajmë të informuar pasi të kemi informacion të ri. Ju gjithashtu mund të merrni informacion të saktë dhe të azhurnuar duke vizituar www.philasd.org dhe duke më ndjekur mua në faqen time në Facebook Live @Phillyschools çdo të Mërkurë në 3 pasdite.

Faleminderit. Ju lutemi të kujdeseni dhe të qëndroni të sigurt.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias